

Afrim Osmani, PhD<sup>1</sup>

UDC:

343.281:343.262(497.7)

**SHËRBIMI SPROVUES NË RM-së – SFIDAT DHE  
PERSPEKTIVAT**

**ПРОБАЦИСКА СЛУЖБА ВО РМ – ПРЕДИЗВИЦИ И  
ПЕРСПЕКТИВИ**

**PROBATION SERVICE IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA -  
CHALLENGES AND PERSPECTIVES**

**ABSTRACT**

In December 2015 the Parliament of the Republic of Macedonia adopt the new law on the probation service, which regulates the work of probation and procedures for the execution of alternative measures: conditional sentence with supervision, work in community service and home detention, the obligations imposed in criminal procedure in accordance with the law, and the execution of parole imposed by the court, which are carried out in the community; purpose, the position of persons in procedure for the execution of alternative measures and obligations and supervision over execution.

Competent organ to carry out the obligations related to the probation service is directorate for execution of sanctions, with particular emphasis on employees within the probation service.

Probation issues are carried out at the request or a court decision, and that during the proceedings and on the basis of the court decree absolute and executable.

Within the directorate for execution of sanctions, are organized probation sectors as organizational units of the directorate at the central level as well as in units of basic courts.

---

<sup>1</sup> Faculty of law – University of Tetova – Macedonia

For the execution of probation, the venue has the directorate according the permanent or temporary residence of the person against who are carried out probation.

So this is the first step in this direction in our country. Although each of the first steps possesses its own difficulties, probation represents a perspective for our country, because this kind of monitoring and supervision of offenders is one of the possibilities of controlling crime and that state continuously must oversee the crime.

**Keywords: probation, the probation service, the directorate for execution of sanctions, probation sectors.**

## 1. Hyrje

Në dhjetor të vitit 2015 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi ligjin e ri mbi shërbimin sprovues, me të cilin rregullohen punët e shërbimit sprovues dhe procedura për ekzekutimin e masave alternative: dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, puna në dobi të përgjithshme dhe burgimi shtëpiak; më pas ekzekutimi i lirimit me kusht të shqiptuar me vendim të gjykatës, etj.

Ligji që trajton shërbimin sprovues filloj të aplikohet që nga 1 nëntori i vitit 2016.

Sistemi i probacionit është pjesë e sistemit të ekzekutimit të sanksioneve, i cili ka për qëllim menaxhimin e plotësisimit të procedurës penale dhe kthimi i sërishëm i kryerësve në bashkësi, në mënyrë e cila nënkupton vlerësim i individual i kryerësve, vëzhgim permanent nga ana e nëpunësve të veçantë, zhvillim të programeve për adresim të sjelljes kriminale dhe mbrojtja e viktimave<sup>2</sup>.

Shërbimi i probacionit është njësi e veçantë organizative të nivelit të sektorit në kuadër të Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe ka për detyrë dhënien e shërbimeve të probacionit<sup>3</sup>.

Si pjesë e reformës të sistemit penalo-juridik të RM-së, është paraparë edhe reformë në sistemin e ekzekutimit të sanksioneve. Në sistemet bashkëkohore penalo-juridike me sistem funksional të

---

<sup>2</sup> Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM-së (2013-2016), Shkup, 2013.

<sup>3</sup> Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM-së (2013-2016), Shkup, 2013.

ekzekutimit të sanksioneve nënkuptohet qasje komplekse që e përfshin si dimensionin e ndëshkimit, po ashtu edhe dimensionet e risocializimit dhe adaptimit social të kryerësve të veprave penale në bashkësi. Në këtë kontekst është paraparë edhe vendosja e sistemit të probacionit në RM-së, me të cilin do të mundësohet implementim praktik të mënyrave alternative të ndëshkimit të kryerësve të veprave penale në liri<sup>4</sup>.

## 2. Çka mundëson sistemi i probacionit?

- Zgjidhjen e problemit më të madh, me të cilin ballafaqohen institucionet ndëshkimore-korrektuese, kurse kjo është stërmbushja e kapaciteteve të institucioneve;

- Respektim të parimeve për krijimin e bashkësisë më të sigurt dhe sigurisë publike dhe në masë të madhe do të ndihmon në riintegrimin dhe rehabilitimin e kryerësve të veprave penale dhe uljen e recidivizmit;

- Është më i lirë se dënimi me burgim;

- Do të kontribuojë në uljen e shkallës së lartë të shqiptimit të dënimit me burgim, me çka do ta ulë shtypjen ndaj burgjeve, duke u mundësuar të punësuarve më të koncentrohen në procesin e risocializimit dhe rehabilitimit të të burgosurve;

- Do të ndihmojë në uljen e infektimit kriminal ndaj kriminelëve të imët, të cilët bien në kontakt me kryerësit e veprave penale me rrezik të lartë në kuadër të mjedisit të burgut;

- Do të kontribuojë për implementimin e standardeve që rrjedhin nga dokumentet ndërkombëtare, që e potencojnë nevojën ulje të nevojës të dënimit me burgim dhe do ta afrojnë Republikën e Maqedonisë deri në plotësimin e standardeve ndërkombëtare penologjike;

- Sanksionet që ekzekutohen në bashkësi do t'u mundësojnë personave të dënuar që t'i mbajnë lidhjet familjen e tyre dhe bashkësinë dhe do tu mundësojë që ta mbajnë punën që kanë pasur para shqiptimit të aktgjykimit<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM-së (2013-2016), Shkup, 2013.

<sup>5</sup> Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM-së (2013-2016), Shkup, 2013.

### 3. Qëllimet themelore të shërbimit sprovues

Qëllimet themelore të shërbimit sprovues mbeten: mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti, si dhe risocializimi dhe riintegrimi i personave ndaj të cilëve kryhen punët sprovuese. Por, mes tjerash si qëllime themelore të këtij shërbimi veçohen:

- Implementimi, zbatimi dhe zhvillimi i sistemit për vlerësim i rregullt statik dhe dinamik për rrezikun dhe nevojat e kryerësve, si dhe identifikimi i aktiviteteve që duhet ti ulin këta rreziqe dinamike për kryerje e serishme të veprave penale dhe shkaktim të dëmit;

- Zhvillim dhe krijim të kushteve të veçanta gjatë procedurës gjyqësore, me qëllim të uljes së shkallës së mbajtjes së paraburgimit dhe të ndihmoj në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me dënimin përkatës;

- Zhvillim të një sistemi të procedurave në nivel të shoqërisë me qëllim të mbikëqyrjes së ekzekutimit të sanksioneve alternative dhe të personave të dënuar që janë liruar nga vuajtja e dënimit me burgim;

- Zhvillim i relacioneve efektive me të gjitha partnerët relevantë në sektorit publik dhe privat, organizatat dhe institucionet në nivel lokal për avancimin dhe përmirësimin e integritit të kryerësve të veprave penale në zhvillimet tradicionale të shoqërisë<sup>6</sup>.

### 4. Parimet themelore në bazë të të cilëve funksionon shërbimi sprovues në RM-së

- personit ndaj të cilit kryhen punët sprovuese i garantohen të drejtat e garantuara me kushtetutën e RM-së, me ligjin mbi shërbimin sprovues dhe me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare;

- personat ndaj të cilëve kryhen punët sprovuese kufizohen në të drejtat vetëm në kufijtë e nevojshme për realizimin e qëllimit të ekzekutimit të tyre;

- rregullat për ekzekutimin e punëve sprovuese aplikohen në mënyrë të paanshme;

- ndalohet çdo formë e diskriminimit, direkt apo indirekt;

- ndaj këtyre personave duhet të veprohet në mënyrë njerëzore, duke e respektuar personalitetin dhe dinjitetin njerëzor;

- ndaj këtyre personave duhet të veprohet në mënyrë e cila i përgjigjet personalitetit të tyre;

<sup>6</sup> Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM-së (2013-2016), Shkup, 2013.

- punët sprovuese mund të ekzekutohen vetëm në bazë të pajtimit personal, pra baza vullnetare, nëse ndryshe nuk e kërkon ligji<sup>7</sup>.

### **5. Kompetenca përmbi shërbimin sprovues**

Organ kompetent për kryerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me shërbimin sprovues është drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, pra e organizon dhe e mbikëqyrë ekzekutimin e punëve sprovuese. Në kuadër të drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve organizohen sektori sprovues si njësi organizative të drejtorisë në nivel qendror si dhe zyrat në rajonin e gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar, në nivel lokal<sup>8</sup>.

Pra, drejtoria është kompetente për organizimin, zbatimin dhe ekzekutimin e punëve sprovuese. Mënyra e zbatimit të mbikëqyrjes së inspektimit profesional-instruktur mbi zyrat sprovuese sipas kompetencës vendore, parashihet me Udhëzues i posaçëm që e sjell ministri i drejtësisë me propozim të drejtorit të drejtorisë. Për ekzekutimin e punëve sprovuese, kompetencë vendore ka zyra e drejtorisë sipas vendbanimit apo vendqëndrimit të personit ndaj të cilit kryhen punët sprovues<sup>9</sup>.

### **6. Të drejtat dhe obligimet e personave ndaj të cilëve ekzekutohen punët sprovuese**

Sipas ligjit për shërbimin sprovues, personave ndaj të cilëve ekzekutohen punët sprovuese nga ana e shërbimit sprovues, u garantohen të drejta dhe obligime. Ndër ta veçojmë:

- personi ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese, të drejtën e mbrojtjes shëndetësore e realizon në pajtim me rregullat e përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore;
- personit ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese i garantohet mbrojtja e personalitetit dhe fshehtësisë së të dhënave personale;
- personit ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese ka të drejtë në këqyrjen e dosjes së vet;
- personit ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese ka të drejtë ankese deri te drejtoria për punët e nëpunësit sprovues nëse mendon se me veprimet e nëpunësit sprovues i janë shkelur të drejtat e tij;

<sup>7</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 7 paragrafët 1-7

<sup>8</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 4 paragrafët 1 dhe 2

<sup>9</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 5 paragrafët 1-3

- personi ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese nënshkrimin e vet vërteton se pranon programin individual për tretman;
- personit ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese mund ta ndërrojnë vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin, vetëm me leje të gjykatës, me vendimin e së cilës është shqiptuar masa alternative ose obligimi i posaçëm<sup>10</sup>.

## **7. Programi individual i tretmanit gjatë shërbimit sprovues**

Nëpunësi sprovues përgatit program individual për tretman për çdo person ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese.

Ky program përgatitet në bazë të vlerësimit të bërë për: personalitetin, mundësitë personale, gjendjen shëndetësore, kualifikimeve profesionale, vlerësimi mbi rrezikun dhe nevojat e personave ndaj të cilëve ekzekutohen punët sprovuese.

Personi ndaj të cilit ekzekutohet shërbimi sprovues njoftohet me programin individual të tretmanit si dhe me pasojat në rast mosrealizimi të tij. Programi individual i trajtimit përgatitet në bashkëpunim me personin ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese.

Programi individual i trajtimit përbëhet nga metodat, procedurat dhe afatet për zbatim, bartësit e aktiviteteve të caktuara dhe të dhënave tjera dhe punëve sprovuese me rëndësi për ekzekutimin e masave alternative dhe obligimeve të posaçme.

Personi ndaj të cilit ekzekutohen punët sprovuese njoftohen me përmbajtjen e programit individual të trajtimit si dhe me pasojat nga mospërmbushja e obligimeve, me çka është i obliguar t'i plotësojë procedurat dhe masat e përcaktuara<sup>11</sup>.

## **8. Ekzekutimi i masave alternative**

### **8.1. Ekzekutimi i dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse**

Ekzekutimi i kësaj mase alternative vjen në shprehje në afat prej 15 ditëve pasi që vendimi gjyqësor është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, të cilin më pas gjykata e dorëzon deri te zyra kompetente sprovuese. Nëpunësi sprovues është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, bashkërisht me personin e dënuar të përpunojë program trajtimi dhe plan për realizimin e mbikëqyrjes

---

<sup>10</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 8

<sup>11</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 10 paragrafët 1-4

mbrojtëse të personit të dënuar, në të cilin përcakton llojin, kohëzgjatjen dhe realizimin e mbikëqyrjes<sup>12</sup>.

Gjatë ekzekutimit të kësaj mase alternative, zyra kompetente sprovuese ka këto kompetenca:

- fton personin e dënuar me kusht në bisedë gjatë kohës së kontrollit;
- cakton terminët kur duhet të paraqitet i dënuari me kusht në zyrat kompetente sprovuese;
- kryen kontroll mbi ekzekutimin e dënimit me kusht dhe i ofron ndihmë personit të dënuar me kusht;
- kryen këqyrje në dokumentacionin e personit të dënuar me kusht, si dhe grumbullon të dhëna tjera të nevojshme për personin e dënuar me kusht nga organet, institucionet dhe organizatat tjera me kërkesë të gjyqit;
- përpilon raportin për ekzekutimin e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe ia dorëzon gjykatës së shkallës parë që ka marr vendimin, edhe atë në çdo katër muaj nëse mbikëqyrja mbrojtëse është përcaktuar deri në një vjet, dhe në çdo gjashtë muaj nëse mbikëqyrja mbrojtëse është caktuar mbi një vjet;
- në rast të revokimit të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, atëherë zyra kompetente e sprovimit i dërgon raport institucionit ndëshkimor-korrektues, në të cilin personi i dënuar është drejtuar në vuajtjen e dënimit me burgim, për aktivitetet e ndërmarra gjatë ekzekutimit të dënimit me kusht dhe sjelljen e personit të dënuar gjatë kohës së kontrollit;
- mban evidencë për ekzekutimin e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse;
- si dhe punë tjera në pajtim me ligjin<sup>13</sup>.

Nëse personi ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë nuk paraqitet në terminët e caktuara nga zyra përkatëse, atëherë, në afat prej 24 orëve, njoftohet MPB për sigurimin e personit në fjalë. Nëse ministria e punëve të brendshme në afatin e caktuar nuk arrin që ta sigurojë personin në fjalë, atëherë njofton zyrën sprovuese, kurse kjo njofton gjykatën e shkallës së parë si dhe sektorin sprovues pranë drejtorisë. Në raste të tilla mund të zëvendësohet kjo masë me masa tjera. Nëse personi ndaj të cilit ekzekutohet dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse nuk i plotëson obligimet me këtë ligj, atëherë gjykata do ta revokojë këtë masë alternative.

<sup>12</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 13 paragrafët 1 dhe 3

<sup>13</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 14

## 8.2. Ekzekutimi i punës në dobi të përgjithshme

Ekzekutimi i kësaj mase alternative vjen në shprehje në afat prej 15 ditëve pasi që vendimi gjyqësor është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, dhe atëherë gjykata e dorëzon deri te zyra kompetente sprovuese dhe njësisë organizative të drejtorisë që i kryen punët sprovuese. Për këtë vendim, zyra kompetente sprovuese njofton qendrën për punë sociale, agjencinë për punësim, ministrinë e punëve të brendshme dhe punëdhënësin, në të cilin personi i dënuar është i punësuar<sup>14</sup>.

Gjatë ekzekutimit të kësaj mase alternative, zyra kompetente sprovuese i kryen këta punë sprovuese:

- fton personin e dënuar në bisedë;
- kryen këqyrje në dokumentacionin për personin e dënuar si dhe grumbullon të dhëna tjera të nevojshme për personin e dënuar me kusht nga organet, institucionet dhe organizatat tjera me kërkesë të gjyqit;
- udhëzon personin e dënuar në ekzekutimin e masës;
- kryen mbikëqyrje mbi ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme dhe i ofron ndihmë personit të dënuar;
- përpilon raporte për ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme dhe ia dorëzon gjykatës që ka marr vendimin në shkallë të parë;
- në rast se gjyqi e zëvendëson punën në dobi të përgjithshme me dënim me burgim, atëherë deri të institucioni ndëshkimor-korrektues, në të cilin personi i dënuar është drejtuar që ta vuaj dënimin me burgim, dorëzon raport për masat e ndërmarra dhe sjelljen e personit të dënuar gjatë ekzekutimit të punës në dobi të përgjithshme;
- mban evidencë mbi ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme;
- si dhe punë tjera të përcaktuara me ligj<sup>15</sup>.

Puna në dobi të përgjithshme ekzekutohet në organe shtetërore, ndërmarrje publike, institucione, njësitë e vetëqeverisjes lokale, organizata humanitare, si dhe subjekte tjera, që kryejnë veprimtari në të cilën mund realizohet qëllimi i ekzekutimit të punës në dobi të përgjithshme. Zgjedhjen e subjektit juridik, në të cilin personi i dënuar duhet që ta ekzekutojë punën në dobi të përgjithshmen e bën nëpunësi sprovues i zyrës sprovuese sipas kompetencës vendore pasi që paraprakisht të merr të dhëna për aftësitë, kualifikimet profesionale dhe gjendjen shëndetësore të personit të dënuar. Puna në dobi të përgjithshme ekzekutohet në subjektin juridik sipas vendbanimit apo vendqëndrimit të personit të

<sup>14</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 17 paragrafët 1 dhe 2

<sup>15</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 18



dënuar. Udhëheqësi i zyrës sprovuese sipas kompetencës vendore drejton personin e dënuar në ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme të subjekti i caktuar juridik, me të cilin është lidhur kontrata. Për ekzekutimin e punës në dobi të përgjithshme personi i dënuar nuk ka të drejtë në kompensim<sup>16</sup>.

### 8.3. Ekzekutimi i burgimit shtëpiak

Vendimin i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, me të cilin është shqiptuar burgimi shtëpiak me mbikëqyrje elektronike, gjyqi në afat prej 15 ditëve nga dita pasi që vendimi gjyqësor është bërë i ekzekutueshëm, ia dorëzon sektori sprovues pranë drejtorisë. Nëse me vendimin gjyqësor është përcaktuar se burgimi shtëpiak do të ekzekutohet me aplikimin e mbikëqyrjes elektronike, atëherë realizimin e kryen drejtoria. Pajisjen për mbikëqyrjen elektronike të personave që vuajnë burgimin shtëpiak e vendos nëpunësi sprovues, i cili jep udhëzimet për përdorimin e saj. Drejtoria drejton me pajisjet, me të cilët ndiqet lëvizja e të dënuarit dhe vend-pozita e tij<sup>17</sup>.

Personit të dënuar që i është shqiptuar burgimi shtëpiak nuk guxon ti braktisë hapësirat e vendbanimit të vet, përpos të caktuara me këtë ligj. Personat e dënuar kanë të drejtë qëndrimi jashtë hapësirave të vendbanimit të vet në kohëzgjatje prej së paku 2 orë në ditë, edhe atë prej orës 13-17. Nëse vjen në shprehje keqpërdorimi i kësaj të drejte, atëherë gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve me propozim të nëpunësit sprovues kompetent dot merr vendim për marrje të së drejtës<sup>18</sup>.

Personi i dënuar mund ti lëshon hapësirat e vendbanimit të vet me vendim të udhëheqësit të zyrës sprovuese ose të ndonjë personi tjetër të autorizuar nga ai në këto raste:

- për shkak të përgjigjes së ftesës të organit shtetëror;
- për shkak të dhënies së provimit;
- për shkak të sëmundjes akute apo kronike, për shkak të kontrollit të rregullt mjekësor ose mjekimit mjekësor;
- për shkak të lidhjes së martesës;
- për shkak të vdekjes së ndonjë anëtari të afërt të familjes;
- për shkaqe të arsyeshme për të cilët personi i dënuar mund të parashtron lutje për braktisjen e vendbanimit<sup>19</sup>.

<sup>16</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 19 paragrafët 1, 2, 3 dhe neni 20 paragrafët 1 dhe 2

<sup>17</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 25 paragrafët 1, 3 dhe 4

<sup>18</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 26 paragrafët 1, 2 dhe 3

<sup>19</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 27

Udhëheqësi i zyrës sprovuese kompetente ose person tjetër i autorizuar nga ai do ta revokojë vendimin për braktisje të hapësirave, në të cilët personi i dënuar jeton, përkatësisht qëndron nëse<sup>20</sup>:

- janë ndërprerë rrethanat nga neni 27 paragrafi 1;
- plotësisht vërtetohet se të dhënat e cekura në lutje të personit të dënuar, në bazë të të cilëve është marr vendimi për braktisjen e hapësirave, në të cilët personi i dënuar jeton, përkatësisht qëndron, janë të pavërteta; dhe
- personi i dënuar e keqpërdor lejen për braktisjen e hapësirave.

### **9. Ekzekutimi i lirimit me kusht**

Nëpunësi sprovues gjatë ekzekutimit të lirimit me kusht i kryen këta punë sprovuese:

- përpunon vlerësim të rreziqeve dhe kushteve për pranimin e personit të dënuar në bashkësi;
- përcakton mundësinë për vazhdimin e realizimit të obligimeve të parapara me programin individual për punë gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim;
- grumbullon dhe dorëzon të dhëna për mundësinë për vendosje dhe punësim të personit të dënuar; dhe
- grumbullon të dhëna tjera dhe bashkëpunon me Qendrat për punë sociale<sup>21</sup>.

Nëpunësi sprovues parashtron raport me shkrim për sjelljen e personit të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit në atë institucion deri te drejtori i institucionit ndëshkimor-korrektues në afat prej 15 ditëve nga përmbushja e kushteve për lirim me kusht nga ana e personit të dënuar. Drejtori i institucionit ndëshkimor-korrektues është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të raportit, të parashtrij propozim për lirim me kusht të personit të dënuar deri te gjykata që ka marr vendimin në shkallë të parë<sup>22</sup>.

Aktvendimin për lirimin me kusht gjykata kompetente e dorëzon deri te zyra sprovuese me kompetencë vendore sipas vendbanimit përkatësisht vendqëndrimit të personit të dënuar, përkatësisht vendit të lirimit të personit të dënuar, në afat prej tre ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Zyra sprovuese me kompetencë vendore në afat prej tetë ditëve, nga pranimi i aktvendimit, njofton Qendrën për punë sociale,

<sup>20</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 29

<sup>21</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 33 paragrafi 1

<sup>22</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 33 paragrafët 2 dhe 3

Agjencinë për punësim, punëdhënësin të cili personi i dënuar punon, përkatësisht ka qenë i punësuar dhe institucionin përkatës shëndetësor. Gjykata me aktvendim vendos nëse ndaj personit të liruar me kusht do të aplikohen masat e mbikëqyrjes elektronike<sup>23</sup>.

Nëse personi i dënuar nuk i plotëson ose në mënyrë të parregullt i plotëson obligimet që i janë përcaktuar, atëherë zyra sprovuese sipas kompetencës vendore e paralajmëron dhe menjëherë e njofton gjykatën kompetente. Nëse personi i liruar me kusht edhe pas paralajmërimit nuk i plotëson obligimet dhe nuk merr pjesë në realizimin e programit individual që i është përcaktuar, atëherë zyra sprovuese sipas kompetencës vendore në afat prej tre ditëve njofton gjykatën që ka marr vendimin në shkallë të parë me propozim për revokim të lirit me kusht<sup>24</sup>.

### **Conclusion**

Probation service is an innovation in our penitentiary system. Probation Service is regulated by a special law on Probation, approved in December 2015, and begins with application since 1 November 2016.

The main institution for the implementation of this service remains the Directorate for Execution of Sanctions: the Probation Sector as the organizational unit of the Directorate at the central level as well as the Offices in the Basic Courts Region with expanded competence at the local level.

The probation service includes three alternative measures, including: conditional sentence with protective supervision, work for community service and domestic imprisonment, and also includes parole.

The probation service is the first reform of this kind in our penitentiary system, and its beginnings represent the greatest challenge for its proper implementation.

### **Literatura**

- Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve “Strategjia për zhvillimin e shërbimit sprovues në Republikën e Maqedonisë (2013-2016)”, Shkup, 2013.
- Gazeta Zyrtare e RM-së nr.226 “Ligji i probacionit”, Shkup, 2015.
- Osmani, A “Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2015.

---

<sup>23</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 34 paragrafët 1, 2 dhe 3

<sup>24</sup> Ligji mbi shërbimin sprovues, neni 35 paragrafët 4 dhe 5